



Only Peace Will Do The Höchstadt Peace Charter

Deklarata e paqes së qyteti të Höchstadt-it u bë për nder të 1000 vjetorit të qytetit tonë nga kontributi i fëmijëve dhe rinisë. Sipas përvojës sonë ka mundësi që të pengohet konflikti luftarak, nëse respektohen këto pika të kësaj shpalljeje.

§1: Nderi dhe e drejta e njeriut

Të gjithë njerëzve iu takon të kenë të drejta të barabarta. Ne i respektojmë dhe nderojmë njerëzit me prejardhje dhe besim tjetër. Ne nuk e tallim, nuk e përqeshim dhe nuk e përjashtojmë askend.

§2: Përkujdesja themelore e gjithë njerëzimit

Ne i përqëndrojmë të gjitha forcat për atë që gjithë njerëzimi të ketë ujë të mjaftueshëm, ushqim, strehim dhe përkujdesje shëndetësore. Ne mundohemi për një ndarje të drejtë të punës dhe një pagesë të mirë.

§3: Arsimi dhe kultura

Ne ndihmojmë që të gjithë fëmijëve e botës t'iu mundësohet shkuarja në shkollë. Të gjitha shkollat duhet të bëjnë edukimin rreth tolerancës dhe njerëzimit. Ne i përkrahim rezultatet kulturore, të cilat na nxisin të mendojmë dhe e rrisin dëshirën për paqe. Ne i përbuzim shfaqjet dhe lojnat, të cilat e madhësojnë luftën.

§4: Pushteti dhe dhuna

Të gjitha grupet shoqërore mund të marrin pjesë në mënyrë demokratike në vendimet politike. Pushteti i politikajve duhet të ushtrohet vetëm nga dashuria ndaj njerëzimit. Ne jemi kundër torturave, dënimeve me vdekje dhe kundër armëve për asgjësime masive. Të gjitha armët e botës duhet t'i nënshtrohen një kontrolli politik dhe vazhdimisht të kompensohen përmes marrëveshtjeve politike.

§5: Miqësia dhe ndihma

Ne u ndihmojmë njerëzve nëpër vendet e varfëra, të dobëtve dhe njerëzve me të meta. Ne nuk heshtim, nëse e vërejmë një padrejtësi. Ne përkrahim qytete-, vëllazërimin e vendeve dhe këmbimin e nxënësve, për të krijuar raporte miqësore dhe për ta nxitur bashkëpunimin në mes të gjitha kulturave.

§6: Besimi dhe pajtimi

Ne lutemi për të gjetur forcë për pajtim. Zoti nuk është përgjegjës për luftë. Të gjithë njerëzit duhet të nisen nga përgjegjësia personale ndaj paqes.

§7: Kontributi personal

Ne e konsiderojmë palën e kundërt si partner të barabartë. Ne përpiqemi t'i përmirësojmë atypëraty gabimet dhe konfliktet. Ne e gjejmë forcën për të kërkuar falje. Ndaj një fjale të ligë, ne nuk përgjigjemi me ligësi, por me pajtueshmëri.